



Prishtinë, 25 nëntor 2016

## **KOMUNIKATË**

### **MBLEDHJA E XII E BORDIT TË ZRRE**

**Bordi i ZRRE ka vendosur që përkohësisht të ndërmarrë masa për t'i ndaluar ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike për qëllim të mirëmbajtjeve të planifikuara nga operatori i rrjetit të shpërndarjes (KEDS), dhe ka vendosur të thelloj hetimin në lidhje me të gjeturat fillestare.**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka shqyrtuar të gjeturat nga verifikimi i ndërprerjeve të planifikuara të energjisë nga KEDS. Verifikimi fillestar i parregullsive të prezantuara nga Komisioni i ZRRE-së ka krijuar bazë të mjaftueshme për Bordin e ZRRE-në, që të reagojë ndaj të gjithë procesit të mirëmbajtjes së planifikuar. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE ka ndaluar përkohësisht ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike për qëllim të mirëmbajtjeve të planifikuara nga operatori i rrjetit të shpërndarjes (KEDS), përpos mirëmbajtjeve të domosdoshme të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Gjithashtu Bordi në këtë mbledhje ka vendosur për lëshimin e 3 Autorizimeve Preliminare, për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Energjetike nga burimet e ripërtërishme të energjisë (nga era), me kapacitet të përgjithshëm prej 105 MW. Këto projekte planifikohet të ndërtohen në Zonën Kadastrale Selac, në komunën e Mitrovicës nga ndërmarrja "SOWI KOSOVO" sh.p.k.